



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 458 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 84 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman-Sardë" 2019*, drejtuar nga Dr. Elvana Metalla (IA), dhe Dr. Etleva Nallbani (CNRS-Francë), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman-Sardë" 2019*, drejtuar nga Dr. Elvana Metalla (IA), dhe Dr. Etleva Nallbani (CNRS-Francë), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Koman

- Gërmime në zonën e poshtme të kodrës së "Kalasë", kisha e lagjes së "Qafës" (Zona 1B).
- Gërmime dhe rievime në zonën e nekropolit qendror. Gërmimi i nekropolit gjatë 2019 do të përqëndrohet në dy sektorë:
 - a) në shtegun veri-perëndimor, që lidh vendbanimin me pllajën e nekropolit;
 - b) në zonën perëndimore, pranë Shën Janit.

Sardë

- Rievime topografike dhe fotogrametri për modelim 3D.
 - Gërmime, në pjesën më të lartë të qytetit të sipërm që synon zbulimin e kishës së majës. Investimi i gërmimit në zonën e kishës, që përkon me zonën më të lartë të vendbanimit, na lejon të verifikojmë origjinën më të hershme të okupimit, i cila nëse ka ekzistuar përkon me zonën e akropolit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**